

VENDIM
Nr. 652, datë 31.10.2018

PËR MIRATIMIN LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS DHE TË PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA, SI AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “LINJA UNAZORE 110 KILOVOLT E SHQIPËRISË SË JUGUT”, NËPËRMJET NJË HUAJE PREJ 37 750 000 EUROSH, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 10249, DATË 11.3.2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe të projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje prej 37 750 000 eurosh, të ratifikuar me ligjin nr. 10249, datë 11.3.2010, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3,
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2228405
Faks: +355 4 2228494

Në vëmendje të:
Operatorit të Sistemit të Transmetimit
Autostrada Tiranë–Durrës
Km 9, Kashar
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të:
Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri

Bashkëpunimi Financiar i Qeverisë Gjermane me Qeverinë Shqiptare

Datë 4 korrik 2018

KfW Development Bank

Zgjatja e afatit të disbursimit

Sarah Bongard
Ref. jonë: BghS
Tel: +49 69 7431-2185
Faks: +49 69 7431-2944
Sarah.Bongard@kfw.de

Linja Unazore 110 kV e Shqipërisë së Jugut

Marrëveshja e Huas dhe e Projektit

Datë 4 janar 2010

Shuma 37,750,000.00 euro

BMZ-nr. 2008 65 188

Nr. i llogarisë së huas: 6672705

E ndryshuar herë pas here (Marrëveshja)

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes së lart-përmendur dhe kërkesës suaj të datës 11 qershor 2018, për një zgjatje të afatit të disbursimit. Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se kemi rënë dakord për shtyrjen e afatit të disbursimit deri më 30 dhjetor 2018. Për të kontribuar në finalizimin me sukses të këtij projekti, KfW-ja është përgatitur që në mënyrë të veçantë të përballojë si kosto dhe shpenzime të saj, kostot shtesë të rifinancimit të shkaktuara nga zgjatja e periudhës së disbursimit të Marrëveshjes në vlerë, prej rreth 34,000.00 eurosh dhe këto kosto dhe shpenzime nuk do t'i ngarkohen Huamarrësit. Megjithatë, për çdo zgjatje të mëtejshme të periudhës së disbursimit sipas Marrëveshjes, KfW-ja rezervon të drejtat për t'i ngarkuar Huamarrësit kostot shtesë të rifinancimit.

Në vijim, jemi dakord me ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes.

Seksioni A. Ndryshimi i Marrëveshjes

Marrëveshja (BMZ-nr. 2008 65 188) do të ndryshohet si më poshtë:

1. Termi “Ministria e Financave” do të fshihet dhe do të zëvendësohet nga “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, kudo që përmendet në tekstin e Marrëveshjes së Huas dhe të Projektit.

2. Neni 3.2. Afati i fundit për të kërkuar disbursim do të fshihet dhe zëvendësohet si më poshtë:

“KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas 30 dhjetorit 2018. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja mund të zgjasë afatin, duke njoftuar Huamarrësin sipas gjykimit të saj.”.

3. Në nenin 13.2 adresa për njoftimin e Huamarrësit do të fshihet dhe zëvendësohet si më poshtë:

“Për Huamarrësin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Tel.: +355 4 2228405

Faks: + 355 4 2228494”.

Seksioni B. Dispozita të tjera

1. Kjo letër nuk e ndryshon ose heq dorë nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, përveç siç është përcaktuar shprehimisht në këtë letër.

2. Dispozitat e nenit 10 (Kostot dhe tarifat publike), nenit 11.5 (Përputhshmëria), neni 13.2 (Adresat), nenit 14.3 (Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë) dhe nenit 14.4 (Forma e shkruar dhe e amenduar), nenit 14.6 (Ligji i zbatueshëm) dhe nenit 14.9 (Mosmarrëveshjet ligjore - Arbitrazhi) të Marrëveshjes, do të përfshihen në këtë letër, siç janë përcaktuar në mënyrë të plotë në të dhe siç referencat në këto dispozita të Marrëveshjes, janë referenca në këtë letër.

Ju lutem, konfirmoni miratimin tuaj për ndryshimin dhe dispozitat shtesë të përcaktuara më sipër, duke nënshkruar në një formë ligjërisht të detyrueshme dhe duke na kthyer një kopje, sa më shpejt të jetë e mundur.

Me respekt,

KfW

Rainer Sünner Sarah Bongard
Menaxher Kryesor Menaxhere Projekti
i Projektit

Lexuar dhe rënë dakord:
Tiranë, 5.10.2018

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Emri: Arben Ahmetaj
Titulli: Ministër

Për dhe në emër të Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)
Emri: Klodian Gradeci
Titulli: